



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Priljezho/Prodato Received/Delivery	28.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTK	5719/2022		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.676/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.28/2020 të datës 30.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.676/2019 të datës 04.11.2019 të parashtruar nga ankuesi nga më adresë banimi kundër Vendimit KZKA Nr.21/2019 të datës 26.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Akt-Njoftimit me numër protokolli 4374/2019 të datës 16.10.2019 për anulimin e konkursit të shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.676/2019 e datës 04.11.2019 e parashtruar nga ankuesi.
- II. *Shfuqizohet* Vendimi KZKA Nr.21/2019 i datës 26.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve si dhe Akt-Njoftimi me numër protokolli 4374/2019 i datës 16.10.2019 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- III. *Mbetet në fuqi* Akt-Njoftimi me numër protokolli 379/2019 i datës 06.09.2019 të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- IV. *Obligohet* Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporti që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, ankuesit ti lëshoj Akt Emërimit lidhur pozitën e përzgjedhur sipas Njoftimit me numër protokolli 379/2019 të datës

06.09.2019 më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] më datë 01.11.2019 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e pranuar në Këshill më datë 04.11.2019 kundër Vendimit KZKA Nr.21/2019 të datës 26.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Akt-Njoftimit me numër protokolli 4374/2019 të datës 16.10.2019 për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës ligjore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të afateve ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.11.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa kjo e fundit më datë 14.11.2019 ka përcjell shkresat lidhur çështjen ankimore.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes shkresës me numër protokolli 5828/2019 të datës 16.12.2019 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.28/2020 të datës 30.06.2022 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, tani ankuesit, dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr. 676/2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5153/2019 të datës 04.11.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KZKA Nr.21/2019 të datës 26.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Njoftimin e datës 16.10.2019 për anulimin e konkursit; Njoftimin e datës 06.09.2019 për kandidatin e suksesshëm; Njoftimin për anulimin e konkursit i datës 07.08.2019; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 27.06.2019; Konkursin e datës 20.05.2019 për pozitën "Inspektor në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturorë"; Zarin e Postës i datës 01.11.2019; Kërkesën për fillimin e rekrutimit-punësimit i datës 17.05.2019; Konkursin e datës 08.08.2019 për pozitën "Inspektor në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturorë"; Autorizimi i DASHC/MAP i datës 02.08.2019; Vendimin me Nr.1554/2019 i datës 26.08.2019 për formimin e Komisionit Përzgjedhës; Akt Emërimit e datës 23.01.2014, 09.11.2018, 19.04.2013; Ndryshim dhe Plotësimi i aktit të emërimit i datës 01.07.2014, 12.01.2015; Formularin Form. MAP-SHCK-04 për regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Lista e ngushtë për test me shkrim; Lista e ngushtë për intervistë; Ftesë për testim me shkrim e datës 28.08.2019; Ftesë për intervistë e datës 03.09.2019; Formularin Form. MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirje nga lista e ngushtë; Formularët

Form. MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularët Form. MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin [redacted] Formularin Form. MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin Form. MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Raportin final me rekomandim i datës 05.09.2019; Kërkesën për punësim e kandidatës [redacted] me dokumentet: Vërtetimin me Nr. 5655/3019 të Policisë së Kosovës, Vërtetimin e datës 06.12.2016, 26.01.2018, Referencën e datës 26.01.2018, Diplomën me Nr. 201, Diplomën me Nr. 13; Kërkesën për punësim të kandidatit [redacted] me dokumentet e bashkangjitura; Kontratë për marrëveshje të veçanta të shërbimit e datës 03.06.2019, Referencë e datës 30.04.2019 dhe 12.02.2019, Vërtetimin e datës 02.05.2017, Referencë me Nr. 536/2 e datës 27.12.2018, Kontratën me Nr. 70-2 e datës 06.03.2018; Kontratë me Nr. 330-2 e datës 31.07.2018, Letër Referencës e datës 30.10.2012, 20.06.2009, 02.12.2017, Kontratë mbi punësimin me Nr. 031/2013 e datës 01.04.2013; Kontratë mbi punësim me Nr.031/2013 e datës 01.07.2013, Marrëveshje vullnetare me Nr. 004/2013 e datës 01.07.2013, Marrëveshje e datës 23.06.2014, Marrëveshje vullnetare me Nr. PZ 007/2014 e datës 02.01.2014, Vendimin me numër Ref.Nr:6-2300 i datës 20.03.2018, Diplomë me Nr. 914, Vendimin me numër Ref.Nr:6-3083 i datës 16.05.2016, Diplomën me Nr. 21251, Certifikatë e Martesës M 10403565; Kërkesën për punësim e kandidatës [redacted] me dokumentet e bashkangjitura: CV-në, Diplomën me Nr. 2883, Vërtetimin me Nr. 03/2019 të datës 28.05.2019; Certifikatën nga Pentium Computer, Certifikatën mbi aftësimin profesional e datës 01.04.2014, Formulari për vlerësimin e punës për konsulentët i datës 17.04.2018, Kontratën për punës e datës 23.05.2002, Vlerësimi i performancës së stafit për vitin 2006, Kontrate pune për mësimdhënës e datës 04.11.2008, Referencë mbi përvojën e punës e datës 09.03.2005, Rekomandim i datës 17.01.2007, Vendimin me Nr. 21 të datës 24.02.2011, Referencën e datës 28.10.2011, Kontratë Pune e datës 31.12.2010, Certifikatën e Gjykatës Themelore në Prishtinë e datës 21.06.2019; Kërkesën për punësim e ankuesit me dokumentet e bashkangjitura: Diplomën me Nr. 200/20 e datës 22.10.2010, Rekomandimin e datës 10.06.2018, Referencën me Nr.422/18 e datës 21.05.2018, CV-në e ankuesit, Certifikatën Themelore në Prizren e datës 10.06.2019, Diplomën për kurs për periudhë 05.05.2022 deri 10.08.2022, Pasqyrën e Illegarisë nga Trusti, Certifikatën e datës 25.04.2012; Kërkesën për punës e kandidatës [redacted] së bashku me dokumentet e bashkangjitura: Diplomën me Nr. 2789 e datës 30.09.1988; CV-në, Certifikatën e Gjykatës Themelore në Prishtinë e datës 24.06.2019, Vërtetimin me Nr. 104/2019 të datës 28.05.2019, Certifikatën e datës 28.06.1991, Librezë e punës me Nr. 221481, Kontratë Pune me Nr. 50/2 e datës 24.03.2006, Kontratë me Nr.CDF/DEM/2015/LS02, Formularë i vlerësimi të punës për konsulentët i datës 7.04.2018; Testin me shkrim të [redacted] Çelësin e përgjigjeve të testit me shkrim dhe Përgjigjen në ankesë e datës 14.11.2019; Njoftimin e datës 26.12.2019 për ankuesin dhe Aktgjykimin A.nr.28/2020 të datës 30.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit [redacted] është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton së Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 02.08.2019, ka shpallur më datë 08.08.2019 Konkursin me numër reference 26/2019-R për pozitën *"Inspektor në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturore-vendi Prizren"*, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Bazuar në Raportin Final dhe Përmbledhjen e Vlerësimeve Individuale të Komisionit Përzgjedhës ankuesi është vlerësuar si kandidati me i suksesshëm me gjithsej 75.95 pikë, dhe si rrjedhojë Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 06.09.2019 ka shpallur Njoftimin me numër protokolli 3793/2019 për kandidatin e suksesshëm në këtë rast ankuesit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit duke vepruar sipas ankesës së kandidates [redacted] me Vendimin KZKA Nr.21/2019 të datë 26.09.2019 ka anuluar njoftimin me numër protokolli 3793/2019 të datës 06.09.2019 për kandidatin e suksesshëm duke e obliguar Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të bëjë rishpalljen e konkursit, konform të cilit vendim, më datë 16.10.2019 është shpallur Njoftim me numër protokolli 4374/2019 për anulimin e Konkursit me numër reference 26/2019-R për pozitën *"Inspektor në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturore-vendi Prizren"*.

Ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KZKA Nr.21/2019 të datës 26.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Akt-Njoftimit me numër protokolli 4374/2019 të datës 16.10.2019 për anulimin e konkursit me pretendimin së Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në mënyrë të paarsyetuar dhe pa konstatim të gjendjes faktike ka nxjerr vendimin e kundërshtuar.

Sipas Konkursit me numër reference 26/2019-R për pozitën *"Inspektor në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturore-vendi Prizren"*, si kriteret të pranimit janë përcaktuar: **Arsimi:** *Diplomë Universitare (Arkitekturë, Histori, Arkeologji, Etnografi, Juridik)*, **përvojë punë:** *së paku 3 vite përvojë pune profesional*, ndërlidhur me këtë Kolegji nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të ankuesit ka konstatuar së i njëjti sipas Diplomës me Nr. 200/10 të datës 22.12.2010 të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit/Fakulteti i Arkitekturës, me datë 16.10.2010 ka përfunduar studimet themelore në Departamentin e Arkitekturës duke marr titullin Bachelor për Arkitekturë, kurse në bazë të Rekomandimit të datës 10.06.2018 të lëshuar nga Kryetari i Këshillit për Trashëgimi Kulturore i Qendrës Historike të Prizrenit ankuesi është i punësuar si anëtar i Këshillit për Trashëgimi Kulturore i Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën nga shkurti 2016 deri në qershor 2019, rrjedhimisht mbi bazën e këtyre dëshmime rezulton së ankuesi ka plotësuar kriteret lidhur me arsimin dhe përvojën e punës, e në këtë kuptim Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes së ankuesit në listë të ngushtë ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1.arsinimi dhe kualifikimi profesional dhe 1.2 përvoja e punës"*.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të vendosjes së drejt dhe të ligjshme lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ka shqyrtuar në tërësi procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference 26/2019-R për pozitën "Inspektor në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturore-vendi Prizren", dhe rrjedhimisht ka konstatuar së shpallja e konkursit ka qenë në pajtim me nenin 16 dhe 17 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komisioni Përzgjedhës është në përbërje të përcaktuar me nenin 7 të po kësaj Rregullore dhe se po ashtu Kolegji lidhur me procedurën e vlerësimit-testimi me shkrim dhe gojë nuk ka gjetur ndonjë shkelje procedurale.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit KZKA Nr.21/2019 të datës 26.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kolegji i Këshillit nga analizimi i të njëjtit ka gjetur së me këtë vendim është anuluar njoftimi me numër protokolli 3793/2019 i datës 06.09.2019 për kandidatin e suksesshëm sipas konkursit me numër reference 26/2019-R për pozitën "Inspektor në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturore-vendi Prizren", me arsyetimin e vetëm së Komisioni Përzgjedhës nuk ka ofruar çelësin e testit për vlerësimin e përgjigjeve të sakta dhe rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së Vendimit të kundërshtuar me ankesë nuk ka arritur të arsyetoj në mënyrë të plotë dhe të drejtë shkaqet që kanë sjell anulimin e këtij konkursi dhe se fakti i mos dorëzimit të çelësit të testit me shkrim nuk përbën bazë të mjaftueshme ligjore për anulimin e një procedurë rekrutimi. Lidhur me këtë konstatim, Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të testeve me shkrim të ankuesit si dhe kandidates [redacted] dhe krahasimit me mostrën e çelësit të testit nuk vëren ndonjë parregullsi përkitazi me vlerësimin e saktësisë së përgjigjeve të dhëna respektivisht Komisioni Përzgjedhës në mënyrë të drejtë ka bërë vlerësimet e testeve dhe mbi bazën e këtyre fakteve nuk është konstatuar ndonjë diskriminim i kandidatëve në vlerësim të testit me shkrim.

Andaj meqenëse procedura e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference 26/2019-R për pozitën "Inspektor në Inspektoratin për Trashëgimi Kulturore-vendi Prizren" nuk ka qenë e përfshirë më shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale, e duke marrë parasysh së ankuesi është vlerësuar si kandidat më i suksesshëm me gjithsej 75.95 pikë, Kolegji duke u bazuar në nenin 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë", e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë Kolegji vendosi që të shfuqizohet Vendimi KZKA Nr.21/2019 i datës 26.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve si dhe Akt-Njoftimi me numër protokolli 4374/2019 i datës 16.10.2019 i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke lenë në fuqi Akt-Njoftimin me numër protokolli 379/2019 të datës 06.09.2019 të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me detyrimin që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ankuesit ti lëshoj Akt Emërimit lidhur pozitën e përzgjedhur sipas Njoftimit me numër protokolli 379/2019 të datës 06.09.2019 më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.676/2019

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

